



Agjencia e Akreditimit e Kosovës  
Kosovo Accreditation Agency  
Agencija za Akreditovanje Kosova

Qendra e Studentëve, kati i II-të  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel : +381 38 213-722  
Fax:: +381 38 213-990  
e-mail: [kaaoffice@gmail.com](mailto:kaaoffice@gmail.com)  
web: [www.akreditimi-ks.org](http://www.akreditimi-ks.org)

Nr. 769113 dt. 29.10.2013

Në mbështetje të nenit 145, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), dhe Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (Nr. 14/2003), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.2/2009), dhe Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e mbajtur më 24 Tetor 2014, mori:

## **V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë e datës 23.10.2013, nr. 2/487 për vazhdimin e akreditimit deri me 30 Shtator 2015 për programin e studimit: Teknologjia Ushqimore me Bioteknologji (BSc).
2. Akreditimi i këtij programi është bërë me 07.03.2011 nga Agjencia e Kosovës për Akreditim për periudhën tre vjeçare 01 Tetor 2011 - 30 Shtator 2014.

## **A r s y e t i m**

KSHC duke u bazuar në faktet e prezantuara dhe në arsyeshmërinë e kërkesë nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë dhe vendimin e KSHC-së të viti 2011 vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij

Vendimi u dërgohet;

- Universitetit "Hasan Prishtina" Fakultetit i Bujqësisë dhe Veterinarisë
- MASHT
- Arkivit të AKA-së



Dr.sc. Ferdije Zhrishi Etemi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

